



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 12
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 07 mars 2018, në orën 09:30

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Faton Topalli, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të tjerë: Basri Sejdiu, UD-Drejtor SHSKUK, Shemsi Veseli –SHSKUK, Ardian Ferizi SHSKUK, Flora Kryeziu UNICEF, Arta Haliti UNICEF dhe mediat .

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresë Haxhijaj, koordinatore e komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, fillimisht Enver Hoti, zëvendëskryetar i parë, e pastaj Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 2.2.2018 dhe 14.2.2018;
3. Takim me Bordin dhe drejtorin e SHSKUK-së;
4. Shqyrtimi i raportit të performancës për Efikasitetin dhe Efektivitetin në Implementimin e Sistemit Informativ unik të Integruar Shëndetësor;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 2.02.2018 dhe 14.2.2018;

Komisioni miratoi, pa vërejtje, procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 2.2.2018 dhe 14.2.2018.

3. Takim me Bordin dhe drejtorin e SHSKUK-së;

Enver Hoti, zëvendëskryetar, përshëndeti përfaqësuesit e SHSKUK-së për përgjigje ndaj ftesës së komisionit, për të diskutuar për sfidat dhe të arriturat në kuadër të punës, si u.d. i drejtorit si dhe bordit të SHSKUK-së.

Basri Sejdiu, u.d. drejtor i SHSKUK-së: Pas pranimit të detyrës, SHSKUK-në e kemi gjetur në gjendje të rënd, dhe prioritet ka qenë dalja nga kjo gjendje e rëndë. I kemi renditur disa prioritete si më urgjente që nuk donë kohë të gjatë për zgjidhje. Fillimisht kemi shkuar me projektet që kanë filluar më herët dhe kanë vazhduar. Ambienti i jashtëm i SHSKUK-së, digjitalizimi i hyrjedaljeve. Prioritet e kemi konsideruar edhe çështjen e emergjencës, mjekimin intensiv si dhe shërbimet të cilat s'kanë qenë aktive, siç është dashur të jenë në fakt.

Investimet në institutin Onkologjik, ku kemi funksionalizimin të shërbimeve dhe pajisjeve si dhe furnizimin me barna.

Kemi funksionalizuar shërbimet në kardiologji me kardiokirurgji invazive, shërbim 24 orë, shërbim i cili ka ndikuar mjaft shumë edhe në kursim të buxhetit si dhe trajtimin e një patologjie e cila është mjaft e shpeshtë. Tashmë kemi filluar me shërbime trajtimin e infarktut si dhe operacioneve në zemër, diku afërsisht janë kursyer një milion euro për një muaj.

Projekt i cili ka filluar më herët është edhe Ortopedia e Re, mirëpo ky projekt s'ka ecur si duhet dhe kemi pasur suficit të buxhetit dhe me një vendim të përbashkët me bordin e kemi ndërpre projektin e Ortopedisë së Re, dhe tentojmë ta ridestinojmë për një projekt tjetër që do të jetë më funksional dhe do të bëjmë funksionalizimin e ortopedisë ekzistuese.

Problem kemi edhe me furnizimin me barna. Në këtë rast, procedurat e prokurimit për shëndetësi janë mjaft problematike, pasi që është furnizim me material specifik si medikamentet, materialet e dializës, shpesh po ndodhe që të kemi ngecje.

Nga Ministria e Shëndetësisë është marrë një hap që të gjitha kontratat të revidohen dhe të procedohen me një procedurë të përshtetshme. Po ashtu, edhe për pajisje mjekësore kemi filluar planifikimet dhe janë dhënë prioritetet për funksionalizim të gjitha shërbimeve. ku ka pasur mungesë dhe jemi në fazën përfundimtare të tenderimit për furnizim.

Hapësirat në SHSKUK-së, ato ekzistuese po bëjmë përpjekje që të bëjmë një riorganizim dhe shfrytëzimin e hapësirave në mënyrë sa më racionale. Shërbimin 24 orë në kardiokirurgji, dhe kemi një fluks më të madh të pacienteve. Në këtë rast e kemi bërë një riorganizim të hapësirës me Reumatologjinë, ku është zhvendosur në një hapësirë tjetër të përshtatshme.

Ambulancat specialiste ekzistuese të cilat janë pjesë e kirurgjisë të barten në objektin e ri i cili është në përfundim e sipër. Planifikojmë që brenda dy muajve të ardhshëm të fillojnë në objektin e ri, në mënyrë që të ofrohen shërbime profesionale për pacientët.

Naser Rugova: Po vërej se kemi një qasje të mirë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave kronike dhe akute, që rëndojnë nëpër disa klinika. Edhe ju, sikurse edhe Bordi i SHSKUK-së duhet të jeni me dinamik në zgjidhjen e kërkesave akute. Dëshiroj ti potencoj disa çështje. Emergjencia kërkon një funksionalizim dhe efikasitet më të madh në triazhimin e sëmundjeve. Diagnostika pas përfundimit të orarit zyrtar të punës, analizat e caktuara nuk kryen në laboratorët

e SHSKUK-së. Laboratorët e SHSKUK-së duhet të funksionojnë dhe të bëhen të gjitha analizat që kërkohen nga ana e stafit profesional.

Ka edhe ankesa për medikamente të caktuara për patologji specifike, për të cilat nuk ju fajësojmë ju. Në Ligjin e Prokurimit Publik për kategoritë specifike duhet t'i akomodojmë në mënyrë ligjore kërkesat e institucioneve të caktuara. Lista e pritjes në ortopedi vazhdon të jetë problem i madh. Kërkoj që të merreni me klinikën e ortopedisë, ka ankesa të bazuara. Po ashtu, edhe te kirurgjia vaskulare, ka mundësi lista e pritjes dhe trajtimi i pacientëve të këtë efikasitet më të madh. Po ashtu, edhe aspekti i konziliumeve për trajtimin e pacientëve jashtë vendit ka neglizhenca dhe joefikasitet. Rastet te cilat nuk mund të trajtohen në klinikë mos të neglizhohen, por të procedohen më tej për trajtim.

Besa Baftiu, kryetare Komisionit: Kërkoj falje për vonesën. Ka kaluar një muaj dhe ishte e arsyeshme që t'ju ftojme në takim për të diskutuar për çështje me rëndësi, siç është pranimi i stafit të mesëm. Problem që është paraqitur edhe përmes mediave. Punësim përmes mitos ose me nepotizëm. Cilat veprime i keni marrë deri me tani? Vazhdon edhe më tej të këtë mungesë të barnave. Për vitin 2018, kemi pasur rritje të buxhetit për 10 milionë euro dhe jemi dëshmitarë se ka mungesë te barnave dhe nuk ka ndryshim nga e kaluara. Ka mungesë të eritropoetinës, besoj se jeni në dijeni kërkesa të shumta janë në procedurë. Pse nuk ka Insulinë që disa muaj? Pse nuk ka barna për leukeminë? Çka keni bërë me menaxhimin e resurseve humane?

Ne e kemi ngritur si shqetësim pranimin e specialistëve, që është bërë pa kriterë. Po theksojmë përsëri asistentet të cilët punojnë në QKUK, punojnë edhe në spitalet rajonale. Pra, kemi informata se ka të tillë që kanë kaluar në QKUK dhe se ata që është dashtë të transferohen nuk u është lejuar transferimi. Në takimin e fundit ke premtuar se do të shqyrtosh këtë problem. Po ashtu, revidimi i listës me barnat esenciale. A kemi përfaqësues nga klinikat në këto komisione? Çka ka ndodhë me koronografin, i cili është premtuar nga ministri që brenda 45 ditëve do të jetë në QKUK dhe ne jemi në dijeni se ai ende nuk është funksional. E vlerësojmë funksionalizimin e shërbimit të kardiokirurgjisë 24 orë.

Haxhi Avdyli: Ne kemi biseduar edhe në takimin e kaluar për menaxhimin, statutin, financimin e shumë tema që kanë të bëjnë me SHSKUK-në. Furnizimin me barna a mendoni ta bëni një racionalizim të listës esenciale të barnave? Problemi është që sallat e operacioneve janë duke funksionuar me vështirësi, pacientët po i blejnë edhe manivelat e doktorëve, fasha, jod pra po mungojnë gjërat esenciale. Për pritjet të gjata për shërbimet. Çka do të bëni rreth kësaj çështje? Sa i përket mjekimit intensiv qendror edhe ambulatet specialistike në takimin e fundit keni dhëne disa data tjera, tash kemi shtyrje ku ekziston problemi për zgjatje? A ka diçka rreth konkurseve për drejtorin e SHSKUK-së dhe klinikave?

Çështje me rëndësi janë edhe pajisjet. Kemi vërejtur se ka pajisje nëpër spitale regjionale dhe nuk përdoren, ndërsa QKUK-ja po vuan për pajisje. Si menaxhment a keni ndonjë plan për racionalizimin apo marrjen e ndonjë pajisjeje që nuk përdoret në spitale dhe të sillen në QKUK, aty ku ka profesionistë dhe mund të përdoren?

A keni ndërmarr ndonjë hap për Klinikën e Neurokirurgjisë ? Është e vlefshme për sëmundjen e trurit dhe kurrizit dhe janë shumë trajtime të shtrenjta. Stafin e kemi të përgatitur nuk kemi nevojë të paguajmë ekstra për staf të ri. Shumë operacione bëhen jashtë vendi për shkak të hapësirave dhe aparaturave. Edhe pas 18 viteve, klinika e ka një sallë dhe një repart të vogël dhe po besoj se do ta keni parasysh të krijoni kushte sepse kolegët e mi s'po kërkojnë paga po kërkojnë kushte për punë, në këtë rast salla të operacionit.

Në komision na ka ardhur një shqetësim nga një koleg i suspenduar. Behet fjale për dr. Skender Telakun, i cili ka parashtruar një ankesë. Çka ka ndodhur me këtë doktor? Pse është suspenduar a kemi ne staf të përjashtojmë tre muaj nga kryerja e shërbimit? A kemi ndonjë prapavije për të

eliminuar nga konkurrimi për drejtor të klinikes? A ka mundur të zgjidhet ky problem pa e suspenduar doktorin me ndonjë ndërmjetësim mes kolegeve?

Time Kadrijaj, tha se propozimi i saj është që ti kushtohet një ditë problematikës së QKUK-së Respektimi i orarit të punës, ka njerëz që nuk vijnë kurrë në punë dhe paguhen. Është padrejtësi ndaj atyre që e respektojnë orarin e punës. Më vjen mirë që kardiokirurgjia është funksionalizuar, është kursyer buxheti si dhe është zvogëluar lista e pritjes së pacientëve. Lajm shumë i mirë që edhe Intenziva qendrore do të lëshohet në funksion me numër të madh të shtretërve.

Bekim Haxhiu: Puna dhe rezymeja hyrëse vërteton se shëndetësia në Kosovë ka vuajtur për menaxher. Prej nivelit qendrore e deri tek niveli me i ulë udhëheqës te sektori i shëndetësisë kemi menaxherëtë dobët. Sot po flasim që edhe listën esenciale ta revidojmë, kjo është absurde pasi që s'ka ku të shkojë me poshtë se lista esenciale.

Me vendim të Kuvendit, kemi vendosur që buxhetin për furnizim me barna nga SHSKUK-ja e kemi bartur në Ministri Shëndetësisë, respektivisht në AFSH. Pra ka barna që mungojnë që tetë muaj dhe MSH-ja akoma si ka filluar procedurat dhe është në fazën e revidimit të listës. Listën esenciale besojani profesionistëve shëndetësorë dhe kolegjiimet e tyre të vendosin për listën esenciale.

Punoni në digjitalizimin e shpërndarjes së barnave i cili pamundëson abuzimin dhe vjedhjen me to dhe njëkohësisht bën me dije sa barna keni në stok dhe lehtëson shumë problemin me furnizim me barna. Lista e pritjes në kardiokirurgji edhe më herët ka qenë një jave apo dhjete ditë dhe tani me një menaxher tjetër përsëri ka filluar të reduktohet dhe atë me aparaturë të njëjtë, pra kjo ka të bëjë me menaxhim të mirë. Unë kam theksuar edhe më herët se nuk kemi nevojë të blejmë aparaturë të re, po të investojmë në salla të operacionit dhe intensive përsëri po diskutojmë se prioritet të jenë sallat e operacionit dhe intensiveja në këtë rast kemi humbur miliona euro dhe disa vite për të caktuar prioritetin.

Vështirë është që të punohet në një kohë kur është shuar QKUK-ja apo nuk kemi Spital Rajonal të Prishtinës pra nuk ka mundësi SHSKUK-ja në këtë formë të përballojë fluksin e pacientëve pa pasur dy institucione të parapara me ligj. QKUK-ja është shuar në mënyrë arbitrare nga ish-ministri dhe drejtori i kaluar i SHSKUK-së, pra duhet të funksionalizohet QKUK-ja.

Nivelizimi i pagave të profesionisteve shëndetësorë sipas profesioneve dhe shkollimit të njëjtë. Një profesionist shëndetësor në spitalin e Prizrenit dhe Pejës paguhet me koeficient 7.2, kurse ai në QKUK, paguhet 6.4 kurse në spitalin e Mitrovicës 5.4, kjo është përgjegjësi e Bordit te SHSKUK-së, që të rregullohet kjo çështje.

Fikrim Damka: Ne si komisioni jemi mandatuar që të bëjmë mbikëqyrjen e kredisë me Austrinë e cila tash dy vite po vazhdon edhe ende nuk është përfunduar, apo sjellja e aparaturës nga Austria, ky është një shqetësim shumë i madh.

A është e vërtet se tash dy vite gastroskopi nuk është duke funksionuar, kurse një vit koranoskopi. Pas vendimit të Gjykatës se Apelit, se kush punon nëpër klinika si specialist, pas 10 viteve përvoje pune bëhet subspecialist, pra e fiton titullin subspecialist. A është e vërtet kjo? Në këtë rast kemi një vendim nga Ministri i MSH-së dhe kjo është shqetësuese që të fitohet titulli subspecialist vetëm se ka 10 vite përvojë punë. Çfarë kuadro do të kemi në të ardhmen nëse avancohen në këtë mënyrë?

Fatmire Kollçaku-Mulhaxha: Kur do të hapet konkursi për ju si u.d. si drejtor i SHSKUK-së si dhe për pozitat e drejtorëve të klinikave? Spitali i Prishtinës është në plan që të realizohet a do të jetë brenda kapaciteteve ekzistuese, a do të jetë në afërsi të QKUK-së pasi siç e dimë Spitali

Amerikan kur është lejuar, është bërë shkelje. Një spital privat nuk mund të jetë në rrezën e ngushtë të një spitali publik.

Sa i përket listës esenciale të barnave, qytetarët që vjen në spital, detyrohen që të blejnë barnat. Nuk e kemi Sistemin e SISH –it funksional, s'i kemi protokollet funksionale që në bazë të tyre mund të përcaktohet se çka është e domosdoshme. Konsiliumet jo vetëm që duhet të funksionojnë për referim pacientëve trajtim jashtë vendit, por duhet të funksionalizohen brenda vetë shërbimit për konsultim të rasteve të renda

Faton Topalli: Po del sikur Bordi është përgjegjës për gjitha këto. Puna e keqe e menaxhimit që është njëra nga problemet më të mëdha për shëndetësi është tek ne këtu në Kuvend. Nuk mund të akuzojmë Bordin se ka mungesë të mjeteve dhe materialeve, ku ne si parlamentarë nuk kemi kërkuar që të dyfishohet buxheti për shëndetësi. Pra, mund të ketë mungesa të shumta. Problemet kryesore në shëndetësi janë me keqplanifikim, menaxhim, keqpërdorim për shkak të organizimit të keq. Ju si profesionist çka bëni me qytetarët që kërkojnë trajtim dhe janë të kategorisë, përfitues të skemës sociale, e ju kërkon që të blejnë barnat, ndërsa ata nuk e kanë këtë mundësi.

Flora Brovina: Ne të gjithë jemi të interesuar që të kemi një shëndetësi më të mirë. Monitorimi i punës suaj dhe i shëndetësisë në përgjithësi, është detyrë dhe përgjegjësi jona. Ne si komision do t'ju monitorojmë në vazhdimësi.

Enver Hoti: Sipas raportit të auditorit 2016, llogaritet që janë 144 pozita të larta brenda QKUK-së me ushtrues detyre. Kjo është shumë shqetësuese. Po ashtu, janë 45 raste apo pozita sekondare me ushtrues detyre. Ju theksuat se keni gjete një gjendje jo të mirë. Si nga hyrjet daljet, disiplina në punë, furnizimi me barna, revidimi i kontratave e deri tek hapësirat e QKUK-së, që sipas kolegëve deri 40 % e hapësirave janë të pashfrytëzuara, apo nuk janë në funksion të stafit dhe të pacientëve.

Edhe pse kemi mungesë buxheti, nga raporti i auditorit, thuhet se ka shumë probleme dhe nuk përputhen raportet me të hyrat, stoqet dhe të dalat, por duhet të menaxhohen me mirë këto ekzistueset, ndërsa edhe mosfunksionimi i laboratorit është shqetësuese.

Kryetarja: A është marrë dikush në përgjegjësi me rastin e vdekjes së tre pacientëve, pra problemi me gazin që ka qenë? Dyshohet se këta pacientë kanë vdekur si pasojë e përdorimit të gazit oksidul. A kemi diçka të re në këtë drejtim ?

Basri Sejdiu: Sa i përket pozitës së drejtorit, nuk e marr si privilegj, por si përgjegjësi, dhe nuk besoj se ka ndërhyrje politike. Sa i përket pyjeve tjera do të përgjigjem shkurtimisht.

Si prioritet i kemi marrë çështjet më akute që ti zgjidhim, e para sa i përket emergjencës e kemi marr si prioritet sepse emergjenca më së paku i përngjanë një reparti emergjent.

E domosdoshme fillimisht ka qenë që të shtohet stafi, jemi në fazën përfundimtare të rekrutimit.

Projektin e renovimit të emergjencës së vjetër e udhëheq Ministria e Shëndetësisë, dhe ka vlerën e 200 mijë euro. Emergjencën do ta pajisim edhe me pajisje në vlerë prej 300 mijë euro.

Diagnostika, e kemi marr si prioritet që të bëhet furnizim më i mirë me reagenca, e që furnizimi me reagenca bien në kategorinë mallra dhe shërbime. Në kategorinë mallra dhe shërbime, gjatë vitit 2018, kemi hyr me borxhe dhe vetëm 100 mijë euro na kanë ngelur për mallra dhe shërbime, pra për medikamente dhe material shpenzues jashtë listës esenciale. Kemi filluar procedurën e tenderimit për furnizimin me reagenca të mjaftueshëm, për një periudhë 3 vjeçare.

Sa i përket listës së pritjes, kemi diskutuar me të gjitha klinikat që kanë lista të gjata të pritjes dhe presim shumë shpejt të zgjidhet ky problem, sidomos kjo listë e pritjes ka qenë më e gjatë në Klinikën e Ortopedisë.

Sa i përket listës për dalje në komision për trajtim jashtë vendit, kjo listë është eliminuar dhe rastet kryhen brenda ditës, ndërsa për listën e pacientëve që presin për shërbime në ortopedi, kemi shikuar faktorët që kanë ndikuar në këtë listë. Ka qenë një pengës në pajisje të cilën jemi duke e rregulluar, por edhe ka pas problem me salla, të cilin e kemi zgjedhur, dhe nga 6 operacione në ditë, tani kryhen 24, që do ta zvogëlojnë dukshëm listën e pritjes. Njëjtë edhe me kirurgjinë vaskulare, ka disa problem me hapësira dhe me anestezion, por jemi duke punuar që edhe në atë klinik të zvogëlohen listat e pritjes, sikurse edhe me oftalmologjinë, kemi pa që ka shumë nevoja dhe e kemi kontraktuar një ekspert nga Lubjana dhe ka filluar të vijë dhe të kryej shërbime, e me këtë do të ketë edhe kursim të buxhetit .

Sa i përket konkursit të infermierëve, jemi munduar të jemi sa më transparentë dhe testi është formuluar një orë para se të fillojë testimi. Kur u shfaqen dyshimet në media, i kemi ftuar edhe policinë të bëjnë hetime. Në fazën preliminare janë të mendimit edhe ata që nuk ka keqpërdorime. Invazivja, në shkurt të viti 2017 ka filluar shërbimin 12 orë, një ndër pengesat ka qenë mungesa e stafit të mesëm por edhe aparati ka qenë shumë i vjetër. Tani aparati është servisuar dhe janë krijuar kushtet që të punohet 24 orë. Me këtë punë të invazives 24 orë, po kursehet edhe kohë edhe buxhet.

Edhe kardiokirurgjia ka filluar të punojë 24 orë, dhe këto të gjitha janë suksese evidente.

Te furnizimi me barna, kontratat janë ato që janë lidhur më herët dhe janë të tejkaluara, nuk ka pasur softuer për përcjellje të kontratave. Tani në Ministrinë e Shëndetësisë është instaluar një softuer, i cili do ti përcjell kontratat edhe kur ju kalon afati, edhe kur tejkalohe. Presim që Ministria e Shëndetësisë shumë shpejt ta tejkalojë edhe problemin e furnizimit me barna.

Sa i përket transferimeve, ka mjek të cilët janë transferuar kur drejtori i një klinike bën kërkesë për staf, e drejtori i klinikës tjetër nuk ka nevojë, atëherë bëhet transferi. Ka qenë edhe një kërkesë e dekanes së Fakultetit të Mjekësisë, sa i përket stafit akademik të cilët janë asistentë, mirëpo specializimet e tyre nuk janë konform profileve ku janë asistentë.

Bordi ka kërkuar një listë të stafit akademik që janë në spitalet tjera, dhe do të bëhet një zgjidhje për të gjithë. Tash do ta kemi edhe një konkurs i cili do ti plotësojë nevojat e spitaleve regjionale, e pastaj do të bëhet transferimi i stafit akademik, nga regjioni në QKUK.

Sa i përket angiografit, i cili ndodhet në Austri, ka pas një ndërprerje të tenderimit pasi operatori nuk ka qenë në gjendje ti kryej punët e përgatitjes së hapësirës. Tani është në proces të tenderimit dhe presim shumë shpejt që kjo të kryhet dhe pas ardhjes së angiografit besojmë se, më listë të pritjes nuk do të ketë.

Sa i përket intensives qendrore dhe ambulancave, kemi qenë pak të varur edhe nga donatorët dhe kemi një premtim që javën e parë të prillit do bëhet hapja solemne, kurse për zyrat e administratës dhe ambulancave specialiste, jemi në bashkëfinancim dhe ato i kemi donacion nga TIKA.

Për neurokirurgji kemi biseduar edhe me drejtorin e repartit dhe jemi në fazën duke kërkuar të bëjmë një zgjidhje që t'ju sigurojmë edhe një sallë, ndërsa kirurgjia plastike të zgjerohet në një aneks ku do tu bëhet edhe një sallë, dhe do të hapet një qendër për trajtim të djegieve.

Sa i përket Skender Telakut, që u potencua si individ, kjo ndërlihet edhe me pyetjen që u parashtrua me vlerësimin që disa kanë fituar titullin subspecialist. Në krejt vendet e Evropës me përvojë të caktuar të punës fitohet titulli subspecialist. Sa i përket Skender Telakut është një komision disiplinor i cili ka marrë informata dhe shkresa nga pacientët të cilëve ju ka imponuar trajtimin jashtë vendit nga doktori në fjalë, dhe për këtë arsye është suspenduar. Çdokush që vërehet që keqpërdor institucionin publik për rekrutim në spitalet private, duhet të marrë dënimin e duhur. Tani drejtori dr. Zaimi ka shprehur dyshime edhe sa i përket diplomave të doktor

Telakut, dhe përmes meje ju ka drejtuar bordit për licencim dhe inspektoratit për hetim të validitetit të diplomave, sepse dyshohet që nuk janë valide, dhe nuk janë të nostrifikuara.

Haxhi Avdyli: Ju po thoni se dikush vetëm në bazë të përvojës së punës e fiton titullin supspecialist, ndërsa dr. Telaku që ka edhe diplomën, e edhe përvojën e punës, po ja kontestoni. Pastaj nuk është hera e par që mjekët ju rekomandojnë pacientëve se cila klinikë është e mirë. Ai vetëm i ka informuar që ka një trajtim më të mirë për atë çështje në Turqi. Këtë çështje keni mundur ta zgjidhni në mënyrë më të mirë, e jo me suspendim, sepse dr. Telaku nuk ka dhënë rekomandim me shkrim, vetëm një sugjerim me gojë dhe nuk mendoj që QKUK-ja ka kuadro me humb siç është dr. Skenderi. Në anën njerëzore mund të ketë vërejtje të sjelljet e dr. Telakut, por në aspektin profesional është një kuadër shumë i nevojshëm për QKUK-në.

Basri Sejdiu: Ndoshta çështja e dr. Telakut nuk është dashur fare të diskutohet këtu, sepse është një komision i cili në mënyrë të pavarur i shqyrton këto raste dhe ashtu ka vlerësuar, ndërsa edhe unë si drejtor jam i interesuar që kudo që ka rekrutim të pacientëve nga institucionet publike, në ato private, të ketë ndëshkime.

I kemi evidentuar të gjitha pajisjet që kanë nevojë për servisim dhe ato që kanë nevoja emergjente të blihen dhe mendoj që çdo klinikë që ka pas mungesë pajisjesh do ti kenë brenda këtij viti.

Me listën esenciale është duke u marr Ministria e Shëndetësisë, por ka kërkuar edhe ekspertë dhe klinikistë nga ne, dhe janë të përfshirë në revidimin e listës esenciale.

Sa i përket koeficientit, ka laramani në sektorë të ndryshëm, për punën e njëjtë, nuk paguhen njëjtë. Po presim që ky problem do të rregullohet me Ligjin e ri për pagat.

Sa i përket eritropoetinës, është nënshkruar sot kontrata dhe shumë shpejt do ta kemi.

Lidhur me vajtje ardhjen e kemi rregulluar hyrje - daljen me kartela, por edhe kemi formuar një komision i cili do ta monitorojë praninë e mjekëve në punë.

Kryetarja: Desha të ju pyes për subspecializimet, derisa po avancohen si subspecialistë personat vetëm me përvojë të punës, ashtu si edhe në shumë vende të Evropës, ka kërkesa të mjekëve specialistë për subspecializim të cilat i ka lejuar Bordi i SHSKUK-së, por Ministria e Shëndetësisë po i vonon. Pse po ndodhin këto vonesa?

Pyetja tjetër ka të bëjë me subspecializimet e neonatologjisë, cili titull pas luftës është ndarë direkt si specializim i neonatologjisë, që askund në botë nuk ka direkt specializim të neonatologjisë, në anën tjetër nuk lejohen neonatologët të punojmë si pediatër. Si do ta trajtoni këtë problem?

Haxhi Avdyli: Kam një pyetje për emergjencën, ju thatë se janë ndarë 200 mijë euro për renovimin e emergjencës së vjetër, çfarë do të bëhet me emergjencën e re, dhe kur planifikohet të përfundohet?

Basri Sejdiu: Sa i përket renovimit të emergjencës së vjetër, është projekt i Ministrisë së Shëndetësisë dhe ajo do bëhet nga ridestini i disa mjeteve si suficit në fund të vitit të kaluar, ndërsa emergjenca e re është në procedurë të ndërtimit dhe parashihet të përfundojë në fund të vitit 2019, se a do të kryhet nuk e di. E domosdoshme është që të përfundohet sa më shpejt renovimi i emergjencës së vjetër, e cila tani fare nuk i përngjan një reparti emergjent.

Shemsi Veseli: Disa çështje që u ceken këtu nuk janë kompetencë e Bordit apo drejtorit të SHSKUK-së, prandaj në takimet tjera do jetë mirë që të jetë prezent edhe ministri apo ndonjë përfaqësues i ministrisë.

Më pëlqej ajo që tha deputeti Faton Topalli, dhe të ju them të drejtën në disa raste ju si deputet, e që jeni edhe mjek, na zhgënjoni, që në rastet kur miratohen ligjet që prekin fushën e shëndetësisë, nuk po merrni nismën e përmirësimit, dhe po bëheni pjesë e degradimit që po ndodh në shëndetësi. Në vitin 2016, Parlamenti në mënyrë të paligjshme ka bartur buxhetin nga SHSKUK-ja, në Ministrinë e Shëndetësisë. SHSKUK-ja ka menaxhuar më mirë buxhetin dhe furnizimi me barna.

Ndër defektet më të mëdha në institucionet tona është bashkëpunimi.

Një ndër mungesat e bashkëpunimit vërehet edhe ajo ndërmjet SHSKUK-së dhe Ministrisë së Arsimit, do të duhej që profesorët dhe asistentët që janë duke punuar edhe si mjek me gjysmë orari ta kenë vetëm një kontratë të integruar, dhe pastaj edhe në SHSKUK ishin liruar më se 100 vende të punës. Kjo nuk po arrihet sepse po mungon bashkëpunimi ndërinstitucional.

Buxheti për QKUK-në është shumë i vogël, ndoshta nuk është faktori i vetëm por është faktori kryesor për një shëndetësi të avancuar.

Sa i përket zgjedhjes së drejtorëve, jemi në proces, është hap konkursi për drejtorin e SHSKUK-së dhe për disa drejtorë të spitaleve të përgjithshme, pastaj do të kalojmë në procesin e zgjedhjes së drejtorëve të klinikave.

Sa i përket problemit të oksidulit dhe oksigjenit, jemi në pritje të raportit të organeve kompetente se edhe ne nuk po dimë që çfarë ka ndodhur. Ne çfarë kemi bërë, kemi kontraktuar një kompani serioze e cila na furnizon me oksidul.

Flora Brovina: Mendoj që QKUK- së, i ka munguar menaxhimi i mirë. Në ministri ka pasur problemin e njohjes së problemit, e pastaj edhe të menaxhimit. Sa i përket punës së Komisionit ne shpesh e kemi kaluar edhe rolin tonë si deputet, vetëm që çështjet të ecin përpara Më pëlqen që ne të takohemi më shpesh, por ne nuk jemi menaxhment, nuk jemi as ministri. Ne monitorojmë Ministrinë e Shëndetësisë, por edhe SHSKUK-në. Ne mund të marrim iniciativa dhe shpesh kemi marr, por mos të hedhim fajë të njëri- tjetri, por të punojmë për atë që jemi kompetent.

Bekim Haxhiu: Sa i përket shërbimit të emergjencës, po kërkohet të bëhet pilot projekt për një komunë për diçka që ekziston Ligj për krejt shërbimet emergjente, për krejt Kosovën. Nuk ka asnjë kërkesë që ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë, e që Kuvendi nuk e ka miratuar, por si e planifikojnë buxhetin në Qeveri, kjo nuk është çështje jona.

Unë kam kundërshtuar bartjen e buxhetit nga SHSKUK-ja në Ministrinë e Shëndetësisë, por kërkesa për bartje ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë. Gjithashtu kam kundërshtuar edhe marrëveshjen me Austrinë dhe tani këto dy çështje që unë i kam kundërshtuar janë dy probleme që kanë ardhur prej Ministrisë së Shëndetësisë.

Edhe një çështje tjetër, tani është konkursi për drejtor të SHSKUK-së, por ju pyes si bord, ku është QKUK-ja, si mundet që në kuadër të SHSKUK-së, me pas drejtor të Qendrës Klinike Universitare të Stomatologjisë, e të mos ketë drejtor të Qendrës Klinike Universitare, që edhe njëra edhe tjetra janë të parapara me Ligj të Shëndetësisë dhe me statut të SHSKUK-së. Duhet një sqarim nga ministri dhe Bordi se a do ketë drejtor të QKUK-së, apo vetëm të SHSKUK-së.

Çështjen e modernizimit të shëndetësisë, do të thosha, njëherë ta ktheni shëndetësinë në normalizim, e atëherë të flasim për modernizim. Çka do të bëni me spitalin e Prishtinës, kur do të ndërtohet, a është menduar që emergjenca e re të shndërrohet në spital të Prishtinës? Kur do të lidhjen klinikat mes vete, e mos të barten pacientët rrugës.

Shemsi Veseli: Të gjitha çështjet që u ngritën në këtë takim duhet të diskutohen në takimet e ardhshme një nga një. Në takim të marrin pjesë të gjithë aktorët kompetentë që nga Ministria e Shëndetësisë, Bordi, drejtori etj.

Bekim Haxhiu: Te nivelizimi i pagave, ministrit i Administratës Publike po kërkon që për nivelizim të pagave ju ti dërgoni shkresë, dhe ai të merret me këtë çështje.

Shemsi Veseli: E kam pa që ka laramani te koeficienti i pagave, rast konkret e kamë vërejtur te fizioterapeutët, 7.2 e ka koeficientin fizoterapeuti në Prizren, 5.4 në Prishtinë, a të njëjtën punë e kryen.

Fatmire Mulhagja-Kollçaku: Kisha ngritur edhe një çështje shumë teknike, që brenda mundësive të rregullohen pritoret e pacientëve.

Ardian Ferizi: Janë në proces dhe do të rregullohen pritoret e të gjitha klinikave.

5. Të ndryshme

Kryetarja : Për këtë pikë të rendit të ditës desha të ju njoftoj që Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, bashkë me të gjithë kryetarët e Komisioneve të Kuvendit, është duke mbajtur takime informuese në lidhje me bisedimet Kosovë- Serbi. Çështjet që bien në domenin e Komisioneve përkatëse të diskutohen fillimisht në komision, e pastaj të diskutohen me Serbinë. Kjo është me rëndësi që janë bërë marrëveshje e komisionet nuk kanë qenë të informuara siç është rasti i marrëveshjes me barnat. Lidhur me këtë kemi edhe një kërkesë të KDI-së për të bërë një hulumtim parlamentar për çështjen e Fondit të Pensioneve, një çështje e rëndësishme e cila do të shtrohet edhe në bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë. A pajtoheni të bëhet ky hulumtim?

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që të kërkohej nga KDI-ja, ta realizojë hulumtimin për Fondin e Pensioneve të ish- Jugosllavisë.

Flora Brovina : Sa i përket bisedimeve Kosovë -Serbi është mirë që të diskutohet, por fillimisht duhet të diskutohet për integrimin e gjithë shëndetësisë në Kosovë, si një sistem i tërësishëm, ashtu si parashihet edhe në Ligjin e Shëndetësisë, e mos të ketë shëndetësi paralele si funksionon spitali në veri.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU